



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO			
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE			
Njësi.org. Org.Jediniça Org.Unit	ARPL	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No	1808-2/24
Nr. i Faqeje Br. Stranica No. Pages	4	Data: Datum: Date:	29.05.24
PRISHTINË / A			No. 1

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	27.05.2024
REFERENC-Ë:	1808/24 - ZSP- ARPI/ 2024
PËR/ZA/TO:	„LAB - OIL,, Sh.p.k. „Berat AHMETI” , Preoc K.Graçanicë
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Izedin BYTYQI, Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së Z. Naser AFIZI, Zëvendësues i drejtorit të ARPL- së Znj. Makfirete DIBRANI, Udhëheqëse e DMRU-së
NGA/OD/FROM:	Myvedete MUJA, Zyrtare e Lartë për të drejtën ujore
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim - Leje Ujore

Të nderuar,

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, ka shqyrtuar kërkesën dhe dokumentacionin tekniko-investiv, për shfrytëzim të ujit, me Nr. të protokollit: 1808/ /24, parashtruar nga „ LAB-OIL” Fsh. Preoc K. Graçanicë, dhe ka vendosur si në Vendim për Leje Ujore, të bashkangjitur kësaj shkresë përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Stalnoq Sekretara / Office of the General Secretary

LU

Datë: 27.05.2024


Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019, shtojcës 1 pika 10 të Rregullorës (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrave, nenin 71 të Ligjit Nr. 04/L -147 Për Ujërat e Kosovës, nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dispozitave ligjore të Udhëzimit Administrativ, MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, nxjerrë këtë:

V E N D I M

APROVOHET kërkesa e palës „LAB-OIL” Sh.p.k. për Leje ujore për shfrytëzimin e ujit nëntokësor nga Pusi, me nr protokoli 1808/24, datë 19.03.2024, K. Graçanicë, Kompani për tregëtimin e karburanteve, sipas kushteve vijuese:

1. Sasia maksimale për shfrytëzim e ujit nëntokësorë nga pusi është $Q_{max} = 2.88$ l/s (dy pikë tetdhjet e tetë litra për sekond), sipas Dokumentacionit të dorëzuar Tekniko – Investiv, në parcelen kadastrale, P-73414058-00590-4, Fsh.Preoc, K. Graçanicë, nga Pusi me koordinata: ($X = 7\ 510\ 273$; $Y = 4\ 715\ 850$);
2. Pala përmes regjistrimit me anën e ujëmatësit, duhet të evidentoj: Prurjen mesatare ditore (l/s), sasinë ditore (m^3 /ditë), dhe sasinë vjetore (m^3 /vit);
3. Për sasinë e shfrytëzuara pala obligohet, që për çdo gjashtë muaj, të informoj me shkrim ARPL/MMPHI, nga momenti i marrjes së lejes ujore;


Faqe 2 nga 4



4. Nr. Serik i ujëmatësit, duhet prezantuar në ARPL/MMPHI, brënda 15 dite dhe i njëjti nuk mund të ndryshohet, për ndërrimin e mundshëm të tijë duhet informuar Organi përgjegjës që e ka lëshuar këtë vendim;
5. Obligimi për kompensimin e ujit të shfrytëzuar, do të përcaktohet me aktvendim të posaçëm nga MMPHI, sipas Udhëzimit Administrativ në fuqi, për Strukturën e Pagesave të Ujit;
6. Për këtë pala obligohet të raportoj shfrytëzimin, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbi sasinë e shfrytëzuar të ujit të matur përmes Ujëmatësit, ashtu që të plotësohet kushti paraprak;
7. Afati i lëshimit të lejes ujore është 5 (Pesë) vite, me mundësi vazhdimi sipas kërkesës së palës;
8. Për vazhdimin e kohëzgjatjes së Lejes Ujore, bartësi është i obliguar që 2 (dy) muaj para skadimit të afatit, të paraqes kërkesë për vazhdimin të lejes ujore;
9. Në rast se pala vendos, lidhur me rritjen apo zvogëlimin e shfrytëzimit, duhet të bëjë kërkesë për ndryshim të lejes ujore;
10. Leja ujore nuk mund të bartet tek personat e tretë, pa informimin e organit kompetent që e ka lëshuar të njëjtën;
11. Validiteti i Lejes Ujore pushon, në rast të mos plotësimit të kushteve të kërkuara më sipër.

ARSYETIM

Zyrtarët përgjegjës, duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ MMPH Nr. 03/2018 për Procedurat për Leje Ujore dhe procedurave të përcaktuara me legjislacionin e ndërtimit, kanë shqyrtuar dokumentacionin e palës për aplikim: "Elaborat hidrogeologjik dhe dokumentacioni investivo - teknik për leje ujore për shfrytëzimin e ujërave nëntokësor nga Pusi, si kompani për tregëtimin e hidrokarbureve "LAB OIL", Komuna Graçanicë; Procesi i punës dhe procesi teknologjik i prodhimit të vajrave dhe fluideve; Punimet hidrogeologjike të pusit të hulumtuar, si dhe rezultatet; Certifikata e Biznesit të Kompanisë "LAB OIL" Sh.p.k. (810800153); certifikata e regjistrimit për kompanin hartuese "GEO ING ARBËRI", Certifikata e Pronësisë P-73414058-00591-4, prone e kompanisë "Lab Oil"; Kopje Plani, P-73414058-00591-4; Certifikata e Regjistrimit të Biznesit për 8 ngastrat P-73414058-00590-2; P-73414058-00590-4; P-73414058-00590-5; P-73414058-00592-14; P-73414058-00592-10; P-73414058-00591-2; P-73414058-00591-3; P-73414058-00590-3; si dhe Kopje e Planit; Certificate pronësisë për Parcelat P-73414042-01699-1; Kopje e planit; Vendim për Pëlqim mjedisor – për Depoe karburanteve të lëngta, naftë dhe benzin në Preoc, Graçanicë, Nr : 14/5598/1-ZSP/20/15, datë: 06.02.20215; Autorizimi për ndërmarrjen projektuese; nga "Lab Oil" sh.p.k., me "Geo Ing Arbëri" sh.p.k., pronar Arbër Sahiti; Deklarat e Projektuesit; Vendim i "GEO ING ARBËRI" për përpilimin e dhe kompletimin e dokumentacionit investivo teknik; Deklarimi i hartuesit të projektit; Harta Topografike; Harta gjeologjike e Pusit P-1; profili i pusit, shtojca 04/01, profili i Pusit, shtojca 05/01; Profili i Pusit –konstruktimi i Pusit; Projekt Konstruktimi i pusit;



Ky vendim hyn në fuqi ditën e nxjerrjes.

KËSHILLA JURIDIKE :

Pala e pakënaqur, ka të drejtë në iniciimin e procedurës së Kontestit administrativ, në Gjykatën Kompetente të Kosovës, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Nr.: 1808/24 - ZSP- 2024, datë: 27.05.2024

Prishtinë

T'i dërgohet:

- Palës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- ARPL-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Komunës Graçanicë;
- Arkivit të Ministrisë.

Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së

